

VENDIM
Nr.772, datë 13.11.2003

**PËR LEJIMIN E DHËNIES ME QIRA TË DISA MJEDISEVE TË QENDRËS KULTURORE
TË FORCAVE TË ARMATOSURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 22 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes që t'i japë me qira fondacionit "Projekti për inkurajimin e Shqipërisë" (AEP), mjediset me një sipërfaqe ndërtese prej 465 m², në ndërtesën e Qendrës Kulturore të Forcave të Armatosura, në Tiranë, sipas planimetrisë (genplanit) që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Sipërfaqja e dhënë me qira, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përdoret për funksionimin e Bibliotekës Britanike dhe për organizimin e kurseve kualifikuese, që do të organizohen nga "Projekti për inkurajimin e Shqipërisë" (AEP), për fëmijët, si dhe për ushtarakët e Forcave të Armatosura.

3. Autorizohet Ministria e Mbrojtjes për lidhjen e kontratës së qirasë me afat 15-vjeçar dhe qira mujore 150 lekë/m², duke zbatuar përcaktimet e tjera të kërërve I pika 5 dhe V-VII të vendimit nr.315, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano



MM		OBJEKTI	Q. K. U.			
		EMERTIMI	KATI PERDHE		GJENDJA EKZISTU	
DREJTORI	ING. I. AGOLLI		AUTOR	ARK. G. DAU	nr. regim	21
SH. SEKTORI	ING. I. AGOLLI		AUTORE	ARK. SH. DANJOLLI	nr. regim	65292
KONTROLLOI			PERPUNOI	T. VILA	shk. det.	p.p.b.
PROPOSITESI			VIZATOI	F. POJANI	foza e pro.	p.zb.
					nr. fletës	1-1
					Seera ofi	3
					Orta:	
					Plata dm ²	

